



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 8 Prot.

Tiranë, më 04.01.2023

VENDIM

Nr.2, datë 04.01.2023

“PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR MBI ZBATIMIN E LIGJIT NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL, NË KONKURRIMET E PLANIFIKUARA PËR T’U ZHVILLUAR NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE GJATË VITIT 2023, ME PROCEDURAT E PRANIMIT NË NIVELIN EKZEKUTIV NË SHËRBIMIN CIVIL, LËVIZJES PARALELE, NGRITJES NË DETYRË DHE PRANIMIT NË TRUPËN E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES (TND)”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 144, datë 22.12.2022, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2023”, ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar llojin dhe objektin e mbikëqyrjeve dhe subjektet që do të kontrollohen gjatë këtij viti.

Në këtë planifikim, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që kanë procedurat e rekrutimit në lidhje me: **a)** pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil; **b)** lëvizjen paralele; **c)** ngritjen në detyrë dhe **ç)** pranimin në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), në institucionet e administratës shtetërore, për të siguruar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritë, ç’ka përbën edhe qëllimin e ligjit për nëpunësin civil, është parashikuar zhvillimi i “mbikëqyrjes së orientuar”, përcaktuar në nenin 14/1, germa “c”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2023.

Për këtë arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/

inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 144, datë 22.12.2022, “*Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2023*”, të Komisionerit, me qëllim që të mbikëqyr zbatimin e ligjit në administrimin e procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar, nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2023,

VENDOSA:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar, me objekt mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2023.
2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

1. Altin Shumeli	Drejtor i Mbikëqyrje
2. Luiseda Zhapa	Inspektor (Anëtar)
3. Behare Hoxha	Inspektor (Anëtar)
4. Ina Skënderi	Specialist IT (Anëtar)

2. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë çdo dokumentacion të nevojshëm, në të gjitha institucionet që nxjerrin akte administrative, apo kryejnë procedura të caktuara, që kanë lidhje me procesin e rekrutimit, të tilla si testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.
3. Me këtë vendim të njihet grupi i mbikëqyrjes dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për të zbatuar këtë vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT

Nr. 8/1 Prot.

Tiranë, më 04.01.2023

MIRATOHET

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA

PROGRAM MBIKËQYRJE E ORIENTUAR

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Departamenti i Administratës Publike (DAP)**
- 2. Objekti i mbikëqyrjes:** Mbikëqyrje e orientuar mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në konkurrimet e planifikuara për t'u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2023, me procedurat e pranimit në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND).
- 3. Baza ligjore:** Ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.
- Ligji nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*.
- Rregullorja *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr.

17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;

VKM nr. 118, datë 5.3.2014, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND- së”, (i ndryshuar);

VKM nr. 242, datë 18.3.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, (i ndryshuar);

VKM nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, (i ndryshuar);

Udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2015, i DAP, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

4. Periudha e mbikëqyrjes:

Mbikëqyrja do të përfshijë mbledhjen online të informacionit të publikuar në faqen zyrtare të DAP, në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurremeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2023, si edhe kqyrje rastësore e disa prej procedurave të konkurrimit.

5. Afati i mbikëqyrjes:

Mbikëqyrja do të fillojë në datë 01.01.2023 dhe do të përfundojë brenda datës 31.12.2023.

6. Procedura që do të ndiqet:

Mbikëqyrja e orientuar do të kryhet nëpërmjet monitorimit online, në faqen zyrtare të DAP, të procedurave të konkurrimit, për të gjitha nivelet e nëpunësisë.

Për dokumentimin e procesit të mbikëqyrjes do të kqyren online të gjitha aktet e publikuara gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duke i pasqyruar të dhënat e

nxjerra nga këto akte, në formë tabelare (excel) me qëllim përpunimin e tyre.

Me përzgjedhje, grupi i punës i ngarkuar me këtë proces, do të ndjekë disa nga procedurat e konkurrimit, duke e evidentuar këtë proces përmes kopjeve të akteve të hartuara gjatë zhvillimit të fazave të procedurës së konkurrimit, si dhe procesverbalin e kqyrjes të mbajtur nga grupi i punës për këtë qëllim.

Me përfundimin e afatit të mbikëqyrjes, do të përgatitet relacioni dhe raporti përkatës, ku do të pasqyrohet informacioni i administruar dhe propozimet përkatëse për mënyrën e ndjekjes së problemeve të evidentuara.

7. Grupi i punës:

- | | |
|-------------------------|---|
| 1. Altin Shumeli | Drejtore i Mbikëqyrjes
(Drejtues metodologjik) |
| 2. Luiseda Zhapa | Inspektore
(Anëtar) |
| 3. Behare Hoxha | Inspektore
(Anëtar) |
| 4. Ina Skendëri | Specialist IT
(Anëtar) |

DREJTIMET E MBIKËQYRJES

1. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, Vendimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave.
2. Pranimi dhe lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive, respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 23 dhe 25, të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të këtyre procedurave.
3. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26, i ligjit për nëpunësin civil.
4. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 29, të ligjit për nëpunësin civil; respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes, gjatë realizimit të procesit.
5. Emërimet në shërbimin civil sipas procedurës së aplikuar:

- lista e fituesve të konkurrimeve 2023;
- lista e fituesve të konkurrimeve të mëparshme;
- në zbatim të vendimeve gjyqësore;
- nga transferimet e përkohshme në përfundim të pezullimit.

6. Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes.

Në vijim të programit të mbikëqyrjes, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për të përfunduar këtë proces.

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2023”*.
2. Materialet që dokumentojnë procesin e rekrutimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë apo pranimit nga jashtë shërbimit civil, për disa procedura konkurrimi të përzgjedhura për verifikim, nga grupi i punës:
 - Shpallja e vendit të lirë (*grup pozicionesh –nivel ekzekutiv/pozicion për ngritje në detyrë - nivel i ulët ose i mesëm drejtues/ nivel i lartë drejtues*).
 - Aktet që vërtetojnë respektimin e afateve në shpallje (*sipas aktit nënligjor dhe udhëzimit të DAP*);
 - Aktet që materializojnë procedurat e ndjekura për fazën e verifikimit paraprak të kandidatëve;
 - Aktet që materializojnë përbërjen e organeve të KPP/KPND/KKP.
 - Pranimi/lëvizje paralele nivel ekzekutiv;
 - Lëvizje paralele/ngritje në detyrë/pranim nga jashtë në nivelin e mesëm dhe të ulët drejtues;
 - Ngritje në detyrë/pranim nga jashtë në nivelin e lartë drejtues (TND);
 - Lista e kandidatëve të skualifikuar – arsyet dhe komunikimi me ta;
 - Ankimimi;
3. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arbana BASHA